



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 721/25 Datë: 20.06.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 138 të mbajtur më 16.06.2025, mori:

V E N D I M

- I.** Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Arteve në Universitetin e Prishtinës për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2030):
- *Artet Dramatike (me 7 specializime), MA 60 ECTS; me kuotë 85 studente për vit akademik.*
 1. Aktrim; 2. Regji teatri; 3. Regji filmi dhe tv; 4. Dramaturgjia dhe skenar filmi e tv;
 - 5. Dizajn skene dhe kostumografi; 6. Produksion; 7. Kamerë dhe montazhe.
 - *Artet Dramatike (me 7 specializime), BA 240 ECTS; me kuotë 85 studente për vit akademik.*
 1. Aktrim; 2. Regji teatri; 3. Regji filmi dhe tv; 4. Dramaturgjia dhe skenar filmi e tv;
 - 5. Dizajn skene dhe kostumografi; 6. Produksion; 7. Kamerë dhe montazhë
- II.** Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III.** Obligohet Fakulteti i Arteve në Universitetin e Prishtinës që deri më datë 30.09.2025 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV.** Obligohet Fakulteti i Arteve në Universitetin e Prishtinës të raportojë dhe arsyetojë në AKA çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- V.** Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Faqe 1 nga 3

ARSYETIM

Fakulteti i Arteve në Universitetin e Prishtinës, brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Artet Dramatike (me 7 specializime), MA 60 ECTS; (R)</i> 1. Aktrim; 2. Regji teatri; 3. Regji filmi dhe tv; 4. Dramaturgjia dhe skenar filmi e tv; 5. Dizajn skene dhe kostumografi; 6. Produksion; 7. Kamerë dhe montazhe.	Agnes Nokshiqi, Blerdi Malushi, Blerta Basholli, Ismet Sjarina, Isak Duraku, Seadet Beqiri dhe Zeni Ballazhi.
2.	<i>Artet Dramatike (me 7 specializime), BA 240 ECTS; (R)</i> 1. Aktrim; 2. Regji teatri; 3. Regji filmi dhe tv; 4. Dramaturgjia dhe skenar filmi e tv; 5. Dizajn skene dhe kostumografi; 6. Produksion; 7. Kamerë dhe montazhe.	Arbënesh Nixha, Arian Krasniqi, Burim Arifi, Ekrem Xani, Elmaze Nura, Hazir Haziri, Ilire Vinca, Latif Hasolli, Luan Jaha, Luan Kryeziu dhe Zymer Kelmendi.

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; Artet Dramatike (me 7 specializime), MA 60 ECTS; (R) vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit është organizuar më 23.04.2025 me këtë përbërje: Darko Lukic, Leo Rafolt dhe Katerina Klimoska.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë ka konstatuar se : nga shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht gjashtë (6) fusha të standardeve të akreditimit dhe Substancialisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.

2. Për programin e studimit; Artet Dramatike (me 7 specializime), BA 240 ECTS;(R) vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 23.04.2025 me këtë përbërje: Darko Lukic, Leo Rafolt dhe Katerina Klimoska.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se: nga shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit dhe Substancialisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 138-të, të mbajtur më datë 16.06.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakultetit të Arteve në Universitetin e Prishtinës dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Arteve në Universitetin e Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,